



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

Datë: 23.05.2025
Numër Protokolli: 3538/2025

A.nr.638/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani, kryetar, Ardita Haxhnikaj -Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Rushit Kajtazi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër me numër A.nr. 638/2025, të datës 11.04.2025, të parashtruar nga ankuesi A.H, kundër organit të punësimit: Komunës së Mitrovicës së Jugut, në çështjen juridike *“kompensim material”*, duke vepruar në pajtim me Nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe Nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të Nenit 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në seancën për këshillin dhe votim më datë 26.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr. 638/2025, të datës 11.04.2025, të parashtruar nga ankuesi A.H.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil A.H, (në tekstin e mëtejme referuar: ankuesi), më datë 11.04.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 2394/2025 të regjistruar nën shenjën A.nr.2394/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se ankuesi është duke e realizuar pagën në klasën profesional 3, nga hyrja në fuqi e Ligjit për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa sipas Akt Emërimit me numër protokolli Nr.01-112/01-0007486, të datës 06.02.2025, është kategorizuar në kategorinë profesional 2, duke pretenduar që kompozimi i pagës të behet në kategorinë profesional 2, nga hyrja në fuqi e Ligjit për Pagat në Sektorin Publik.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 18.04.2025 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Mitrovicës së Jugu, ndërsa Këshilli më datën 28.04.2025 ka pranuar përgjigje në ankesë nga, Komuna e Mitrovicës së Jugut, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin në vijim Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën me numër protokollit 2394 të datës 11.04.2025 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt Emërimit me numër protokollit Nr.01-112/01-0007486, të datës 06.02.2025; Ndryshimi dhe plotësimi i Akt Emërimit me numër protokollit 01/11228827, i datës 01.11.2013; Kopje e letërnjoftimit për A.H; Zarfë i postës së Kosovës i datës 10.04.2025; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 18.04.2025, dërguar nga R.K, për L.M; Përgjigjen në ankesë me numër protokollit 638/2025, e datës 28.04.2025; Lista e pagave e muajt janar e vitit 2023; Lista e pagave e muajt janar dhe shkurt e vitit 2024; Vendimi Nr.08/226, i datës 23.10.2023, i Qeverisë së Republikës së Kosovës; Katalogu i vendëse të punës; Rregullorja 02/2024, për Ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 01/2022, për Organizimin Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës, Komunale; Vendimi me numër protokollit Nr.01-120/04-0080311, i datës 17.12.2024; Përshkimi i Detyrave të Punës për pozitën Zyrtar i Gjendjes Civile; Diplomë me numër protokollit 141, e datës 01.01.2010, për A.H, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Diplomë me numër protokollit 73/45-65, e datës 27.05.2015, për A.H, e lëshuar Kolegji UBRT; Vendimi me numër protokollit Nr.01-113-59186 i datës 02.07.2015; Lista e pagave e muajt mars e vitit 2015.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa e ankuesit është ***e pabazuar, sepse:***

Nga administrimi i provave të lëndës, Kolegji ka gjetur se ankuesi fillimisht sipas Ndryshimit dhe Plotësimit Akt emërimit me numër 01-112-27827 të datës 01.11.2013 ka qenë i punësuar në pozitën e punës “Zyrtar i Gjendjes Civile”, në Drejtorinë e Administratës së Përgjithshëm, tutje Komuna e Mitrovicës së Jugut, më datë 26.12.2024 ka miratuar Rregulloren 02/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores 01/2022 për Organizimin dhe Sistematizimin dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale, ndërsa përmes vendimit me numër protokollit Nr. 01-112-120/04-0080311 të datës 17.12.2024, i nxjerr nga Kryetari i Komunës së Mitrovicës së Jugut është aprovuar Klasifikimi i Vendeve të Punës, në Komunën e Mitrovicës së Jugut, pas aprovimit të klasifikimit të vendeve të Punës, Menaxheri i Burimeve Njerëzore i Komunës së Mitrovicës së Jugut, ka përgatitur Akt Emërimit Nr.01-112/01-0007486, e datës 26.02.2025, me të cilin akt emërim ankuesin është sistemuar në pozitën “Zyrtar i Gjendjes Civile”, dhe atë me koeficient të pagës 5.50, të njëjtin akt emërim ankuesi e ka nënshkruar.

Ankuesi A.H, me datë 11.04.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se ka bërë kërkesa të vazhdueshme tek Menaxheri i Burimeve Njerëzore i Komunës së Mitrovicës së Jugut me pretendimet që pagesa ankuesit ti bëhet në mënyrë retroaktive nga hyrja në fuqi e Ligjit për Pagat në Sektorin Publik.

Kolegji i Këshillit për vendosje të drejtë dhe meritore lidhur me këtë çështje ankimore, analizoj bazën ligjore në fuqi lidhur me procedurën e transferimit të nëpunësve civil në rast të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, gjegjësisht Kolegji ju referua nenit 66 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë me të cilin përcaktohet se: “1. Nëse për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, pozita e mëparshme e një nëpunësi/i civil shuhet, ajo/ai mund të transferohet në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori. 2. Transferimi, sipas paragrafit 1. të këtij neni, mund të bëhet: 2.1. në të njëjtin institucion; 2.2. në institucionin që është bashkuar institucioni i shuar, në institucionin që është ndarë apo në institucionin që ka marrë funksionet që kryente më parë nëpunësi/i; 2.3. në agjencinë ekzekutive të institucionit të ristrukturuar; 2.4. në një institucion tjetër të shërbimit civil. 3. Në çdo rast shuarje apo ristrukturimi të institucionit krijohet komisioni i ristrukturimit që shqyrton mundësitë e sistemimit të çdo nëpunësi/i civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunësi/it në një pozitë të lirë, për të cilën i plotëson kërkesat e vendit të punës. 4. Vendimi përfundimtar i transferimit merret nga njësi përgjegjëse në bazë të propozimit të komisionit. 5. Nëpunësi/i mund të refuzojë transferimin vetëm për arsye të parashikuara në paragrafin 3. të nenit

63 të këtij ligji. Refuzimi i transferimit për arsye të tjera, përbën shkak për lirimin nga shërbimi civil. 6. Komisioni i ristrukturimit, i parashikuar në paragrafin 3. të këtij neni, drejtohet nga njësia përgjegjëse dhe në të bëjnë pjesë përfaqësuese të institucioneve të parashikuara në nën-paragrafët 2.1., 2.2., 2.3. apo 2.4. të këtij neni, sipas rastit ku bëhet ristrukturimi përkatës. 7. Qeveria, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për administratën publike, me akt nënligjor, miraton procedura të hollësishme për zbatimin e këtij neni. 8. Rregullat për zbatimin e këtij neni për nëpunëset/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, rregullohet me këtë ligj dhe me akt të veçantë të miratuar nga organet kompetente të këtyre institucioneve”.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit në trajtimin e pretendimeve ankimore mori për bazë edhe dispozitat e Rregullores Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civil, pikërisht nenin 12 paragrafi 1, 2 dhe 3, ku parashihet: 1. Nëse për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, pozita e mëparshme e një nëpunësi civil shuhet, ai mund të transferohet në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori. 2. Shuarja apo ristrukturimit i institucionit përcaktohet në legjislacionin përkatës për organizimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura. 3. Transferimi sipas paragrafit 1. të këtij neni, mund të bëhet: 3.1. në të njëjtin institucion; 3.2. në institucionin që është bashkuar institucioni i shuar, në institucionin që është ndarë, apo në institucionin që ka marrë funksionet që kryente më parë nëpunësi; 3.3. në agjencinë ekzekutive të institucionit të ristrukturuar; 3.4. në një institucion tjetër të shërbimit civil, nenin 15 paragrafi ku thuhet se: 1. Nëpunësi i transferuar në pozitën e të njëjtës kategori që ka qenë, për shkak ristrukturimit të institucionit, e merr pagën e pozitës në klasën që është transferuar.

Bazuar në kuadër ligjor si më sipër, Kolegji i Këshillit nga shqyrtimi i provave material të çështjes ka konstatuar së sistemimi i ankuesit sipas vendimit të kundërshtuar më ankesë ka ndodhur si pasojë e riorganizimit të institucionit punëdhënës në këtë rast Komunës së Mitrovicës së Jugut, rrjedhimisht si rezultat i hyrjes në fuqi të Rregulloren 02/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores, 01/2022 për Organizimin dhe Sistematizimin dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale të datës 26.12.2024, e sipas të cilit akt (shtojca Nr.1) pozita të cilën ankuesi e mban sipas akt emërimit është klasifikuar si pozitë në kuadër të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshëm, me emërtim: Zyrtar i Gjendjes Civile” kategoria: profesionale, klasa Gj35: profesional 2, koeficienti i pagës:5.50. Andaj, mbi bazën e këtyre fakteve rrjedhë se Komuna e Mitrovicës së Jugut, ka vepruar në pajtim më ligjin material sepse ankuesi është sistemuar në pozitë të njëjtë dhe se klasifikimi i pozitës në klasë dhe koeficient të pagës është në pajtim me Ligjin Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë përkatësisht shtojcën Nr. 10.7, sipas të cilës pozita Profesional 2, i referohet Gj35.

Ndërsa, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon së që ti behet kompensimin nga pozita profesional 3, në pozitën profesional 2, që nga Hyrja në fuqi e Ligjit për Pagat e Sektorit Publik. pas Kolegji i Këshillit konton se ky pretendim ankimor i ankuesit është i pa bazuar, sepse ankuesit pas miratimit Rregulloren 02/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores, 01/2022 për Organizimin dhe Sistematizimin dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale, të datës 26.12.2024, dhe vendimit me numër protokollit Nr. 01-112-120/04-0080311, të datës 17.12.2024, i nxjerr nga Kryetari i Komunës së Mitrovicës së Jugut ka aprovuar Klasifikimin e Vendeve të Punës, në Komunën e Mitrovicës së Jugut, ankuesi është sistemuar në pozitën Zyrtar i Gjendjes Civile, sipas Akt Emërimit me numër protokollit Nr. 01-112/01-0007486, të datës 26.02.2025 klasa e pagës Gj35 dhe atë me koeficient të pagës 5.50, prandaj bazuar në konstatimet si në arsyetimin e vendimin. Kolegji i Këshillit konstaton se Komunës e Mitrovicës së Jugut, ka vepruar në pajtim Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, Rregulloren (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, katalogun e Vendeve të Punës dhe mbi këtë bazë pretendimi ankimor i ankuesit është i pa bazuar sepse sistemimi i ankuesit në pozitën e lartcekur është bërë si pasojë e Klasifikimit të Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Bazuar në të gjeturat dhe konstatimet si më sipër si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.638/2025

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- *Ankuesit A.H;*
- *Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës së Jugut; si dhe,*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*